



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

ASAMBLEJA

Prot 839

Tiranë, 16.11.2023

Vendim nr. 64, datë 16.11.2023

Për shpalljen e konkursit për ringritjen e Akademisë së të Rinjve dhe për pranimet e reja sipas Ligjit dhe Statutit

Referuar nenit 5 pika ç dhe nenit 20 të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 47 të Statutit të saj;

Mbështetur në frymën e Kartës themelore për akademitë e të rinjve, miratuar nga ALLEA dhe miratuar për vendin tonë nga kjo Asamble;

Pasi konstatoi se Akademia e të Rinjve e Shqipërisë është ngritur me një akt nënligjor (vendimi nr. 14 datë 07.06.2017 i Kryesisë) dhe jo referuar ligjit në fuqi për Akademinë e Shkencave; si dhe se pjesës më të madhe të anëtarësisë së deritashme të saj i ka mbaruar mandati;

Asambleja, në mbledhjen e saj të datës __.11.2023,

Vendosi:

1. Akademia e të Rinjve e Shqipërisë të ringrihet sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit të saj, nëpërmjet pranimeve të reja;

2. Të shpallet konkursi për pranime të reja në Asamblenë e të Rinjve; Konkursi të zhvillohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr. 53/2019, në nenin 47 të Statutit dhe në pikat 3 dhe 4 të Statutit të Akademisë së të Rinjve. Numri fillestar i anëtarëve të rinj të Akademisë së të Rinjve të jetë jo më shumë se 12. Të ftohen në konkurs studiues të rinj nga të gjitha fushat dhe të ruhen raportet ndërmjet fushave;

3. Për zhvillimin e konkursit për pranimet e reja të ngrihet një komision me 7-9 anëtarë, të propozuar nga Asambleja;
4. Konkursi të mbyllet më datën 25 janar 2024. Shpallja e fituesve jo më vonë se data 5 shkurt 2024;
5. Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe komisioni i ngritur të kujdesen sipas ligjit për konstituimin e Akademisë së të Rinjve deri në fillimin e vetëveprimit të saj;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

